



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 54

2002

Shtator

PËRMBAJTJA

	Faqe
Dekret nr.3443, datë 26.8.2002	Për caktimin e datës së zgjedhjeve të pjesshme për kryetar komune në komunën Dajt, qarku Tiranë..... 1539
Vendim i KM nr. 410, datë 29.8.2002	Për shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme, të cilat preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Gjirokastrër-Kakavijë në territorin e qarkut të Gjirokastrës 1539
Vendim i KM nr. 411, datë 29.8.2002	Për kalimin e disa mjediseve në administrimin e Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të paluajtshme dhe të zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme Tiranë, Korçë dhe Durrës 1547

Vendim i KKRT nr. 108, datë 29.8.2002	Për dhënie licence për radio vendore private “Prespa”.....	1551
Vendim i KKRT nr. 109, datë 29.8.2002	Për dhënie licence për ritransmetim të programeve të huaja radio në shqipëri “BBC world service”	1551
Vendim i KKRT nr. 110, datë 29.8.2002	Për dhënie licence për ritransmetim të programeve të huaja televizive në Shqipëri “TV 5”	1552

DEKRET
Nr. 3443, datë 26.8.2002

**PËR CAKTIMIN E DATËS SË ZGJEDHJEVE TË PJESSHME PËR KRYETAR KOMUNE
NË KOMUNËN DAJT, QARKU TIRANË**

Në mbështetje të nenit 92 germa "gj" të Kushtetutës, si dhe të neneve 4 dhe 11, pika 5 të ligjit nr.8609, datë 8.5.2000 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", ndryshuar me ligjin nr.8780, datë 3.5.2001 bazuar në njoftimin e Kryeministrit,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zgjedhjet e pjesshme për kryetar komune në komunën Dajt, të Qarkut Tiranë, të zhvillohen ditën e dielë, datë 29 shtator 2002, ndërsa raundi i dytë të zhvillohet ditën e dielë, datë 13 tetor 2002.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Alfred Moisiu

VENDIM
Nr. 410, datë 29.8.2002

**PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, TË
CILAT PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR GJIROKASTËR - KAKAVIJË
NË TERRITORIN E QARKUT TË GJIROKASTRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 1, 20 dhe 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", me propozimin e Ministrit të Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme të pronarëve, të cilët preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Gjirokastrë-Kakavijë në territorin e qarkut të Gjirokastrës.
2. Shpronësimi të bëhet në favor të Ministrisë së Transportit dhe Telekomunikacionit.
3. Pronarët e pasurive të paluajtshme që shpronësohen të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqet 50 923 m² tokë/arë, 9 565 m² truall, 24 957 m² kullotë dhe 741 664 lekë kultura bujqësore, vlerësuar në shumën e përgjithshme prej 59 333 764 (pesëdhjetë e nëntë milionë e treqind e tridhjetë e tre mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e katër) lekësh.

4. Vlera e shpenzimeve procedurale të jetë në shumën prej 756 000 (shtatëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë) lekësh.

5. Fondi prej 60 089 764 (gjashtëdhjetë milionë e tetëdhjetë e nëntë mijë e shtatë qind e gjashtëdhjetë e katër) lekësh të përballohet nga Buxheti i Shtetit i vitit 2002, zëri “Shpronësime”, miratuar për Ministrinë e Transportit dhe Telekomunikacionit.

6. Shpronësimi të përfundojë brenda datës 30.9.2002.

7. Ngarkohet Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr. 411, datë 29.8.2002

**PËR KALIMIN E DISA MJEDISEVE NË ADMINISTRIMIN E ZYRËS QENDRORE TË
REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME DHE TË ZYRAVE TË
REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME TIRANË, KORÇË DHE DURRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 36 të ligjit nr.7843, datë 13.7.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” dhe të neneve 6 e 10 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, me propozimin e Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në administrimin e Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe të zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Tiranë, të mjediseve të ish-goditës së ndërmarrjes elektroteknike në rrugën “Jordan Misja”, me sipërfaqe të përgjithshme 7 500 m², nga të cilat 2 500 m² janë sipërfaqe trualli nën objekt dhe 5 000 m² janë truall funksional, sipas planvendosjes, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Kalimin në administrimin e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme Korçë, të mensës së ish-uzinës së instrumenteve Korçë, në rrugën Korçë-Maliq, me sipërfaqe të përgjithshme 1 115 m², nga të cilat 460 m² janë sipërfaqe trualli nën objekt dhe 655 m² janë truall funksional, sipas planvendosjes, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Kalimin në administrimin e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme Durrës, të disa mjediseve të godinës së fermentimit të duhanit Durrës, me sipërfaqe të përgjithshme 600 m², nga të cilat 440 m² janë sipërfaqe trualli nën objekt dhe 160 m² janë truall funksional, sipas planvendosjes, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. Ngarkohen Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme në Tiranë, Korçë dhe Durrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr. 108, datë 29.8.2002

PËR DHËNIE LICENCE
PËR RADIO VENDORE PRIVATE “PRESPA”

SUBJEKTIT: Z. LLAZI NIKOLA

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. T’i japë subjektit z.Llazi Nikolla licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator vendor radio FM private, në fushën e transmetimeve radiofonike tokësore me modulim në frekuencë për një periudhë prej 3 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence.

2. Licenca, bashkëlidhur, përmban kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zonat e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sefedin Çela

VENDIM
Nr. 109, datë 29.8.2002

PËR DHËNIE LICENCE
PËR RITRANSMETIM TË PROGRAMEVE TË HUAJA RADIO NË SHQIPËRI “BBC
WORLD SERVICE”

SUBJEKTI: BRITISH BROADCASTING CORPORATION

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. T’i japë subjektit juridik, British Broadcasting Corporation, licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator për ritransmetimin e programeve të huaja radio me përsëritësa BBC, për një periudhë prej 4 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence.

2. Licenca, bashkëlidhur, përmban kushtet e licencës, ku përfshihen zonat e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sefedin Çela

VENDIM
Nr. 110, datë 29.8.2002

PËR DHËNIE LICENCE
PËR RITRANSMETIM TË PROGRAMEVE TË HUAJA TELEVIZIVE
NË SHQIPËRI “TV 5”

(PËRFAQËSUAR NGA Z.SAMUEL RICHARD)

SUBJEKTI: TV5

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. T'i japë subjektit TV 5 licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator për ritransmetimin e programeve të huaja televizive me përsëritës TV 5, për një periudhë prej 4 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence.

2. Licenca, bashkëlidhur, përmban kushtet e licencës, ku përfshihen zonat e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sefedin Çela

Fletorja Zyrtare gjendet:

- Në çdo njësi postare të çdo qyteti;
- Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
Rr.Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

- Kodi Penal (të azhornuar)
- Kodi i Procedurës Penale (të azhornuar)
- Kodi Civil (të azhornuar)
- Përmbledhje të Legjislacionit në fushën e transporteve (Kodi Rrugor dhe ligji për transportet)
(të azhornuar)
- Kodi Zgjedhor (të azhornuar)

U dorëzua për shtyp më 10.9.2002

Doli nga shtypi më 11.9.2002

Tirazhi: 4250 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2002

Çmimi: 150 lekë